

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
Për Programin e studimit Master Profesional në
“Menaxhim në Sport dhe Turizëm”
Universiteti i Sporteve të Tiranës

Eksperti i vlerësimit të jashtëm:

Prof. Dr. Shyqyri Llaci

Prof.As. Roland Çerepi



Qershor/2018

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm

Tabela e të dhënave të licencimit për programin e studimit:		
1	IAL Aplikues:	Universiteti i Sporteve të Tiranës
2	Departamenti përgjegjës/Fakulteti	Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit/ Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit
3	VBA/Urdhëri i licencimit	VBA Nr. 18, datë 19.05.2017/ Urdhër Nr. 395, datë 05.09.2017
4	Titulli i programit të studimit:	Master Profesional në Menaxhim në Sport dhe Turizëm
5	Cikli i studimit:	Cikli II
6	Kohëzgjatja e programit të studimit:	1 vit akademik
7	Kreditet në total (ECTS):	60 kredite (ECTS)
8	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
9	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
10	Programi ofrohet nga institucioni	Nga vetë institucioni
11	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	N/A
12	Diplomë e përbashkët/Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	N/A
13	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	7
14	Aktivizimi i programit të studimit	2017-2018
15	Brezi i parë i diplomimit të studentëve	2018
16	Numri i studentëve	16

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit “Master Profesional” në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm” është licencuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. Nr.395, datë 05.09.2017 “Për hapjen e programit të studimit të Ciklit të dytë “Master Profesional” në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, të Universitetit të Sporteve të Tiranës”, bazuar në Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 18, datë 19.05.2017 “Për hapjen e programit të studimit të Ciklit të dytë “Master Profesional” në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, të Universitetit të Sporteve të Tiranës”.

Programi është i organizuar me një vit akademik, 2 semestra në lëndë mësimore, të cilat janë të vlerësuara me 60 kredite (ECTS).

Njësia Bazë përgjegjëse për këtë program studimi është Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit, pjesë e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit.

Ky program studimi vlerësohet për herë të parë në kuadër të akreditimit të tij.

Vlerësim i ekspertëve të jashtëm për Programin “Master Profesional” në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, u realizua në kuadër të procesit të riakreditimit, duke u bazuar:

- në raportin e vlerësimit të brendshëm.
- në shqyrtimin e Dosjes së vetëvlerësimit dhe të gjithë dokumentacionit përkatës,
- nga informacioni dhe gjetjet e mbledhura në vizitën dyditore të kryer në UST.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

Përbërja e GVJ:


- Prof.Dr. Shyqyri LLaci
- Prof.As. Dr. Roland Çerepi

Gjatë zhvillimit të procedurës, GVJ, është asistuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL, Renata Qatipi.

Më datë 27.06.2018, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare me Nr. 89/9 Prot., datë 27.06.2018 me lëndë “Njoftim për dërgimin e Draft-Raportit të Vlerësimit të Jashtëm”, UST është njohur me Draft-Raportin e Grupit të Vlerësimit.

Më datë 29.06.2018, UST përcjell nëpërmjet sistemit AMS të ASCAL përgjigjen për Draft-Raportin, me Nr. 1029 Prot., datë 29.06.2018, “Observacion mbi Draft-Raportin e Grupit të Vlerësimit të jashtëm, për programin e studimit Master Profesional “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”. Dokumenti është përcjellë zyrtarisht me datë 03.07.2018. Në këtë observacion institucioni deklaroi se “... konkludoi se është dakort me të. Për të ardhmen, do të punohet për përmirësimin e këtij program studimi duke u bazuar në rekomandimet e GVJ”.

Draft Raporti bëhet Raport përfundimtar i vlerësimit.



1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhim në Sport dhe Turizëm”, (më tej MP në MST) ofruar nga Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit, në Fakultetin e Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit, UST, i cili po mbyll brezin e parë të studimit, vlerësohet si zgjedhje e duhur, me perspektive të garantuar. Qëllimi është furnizimi i tregut sportiv dhe turistik me administratore të kualifikuar.

Ky është një program akademik i orientuar drejt tregut të punës, i cili ofron përgatitje profesionale në zbatimin e parimeve të biznesit në sport dhe industrinë e turizmit (RVB fq 12).

Bashkërendimi me bizneset e interesuara, me klubet dhe federatat sportive, grupet e interesit, do të rrisë nevojën për specialistë të këtij profili.

Gjatë vizitës në institucion dhe informacionit në RVB, rezulton se ky program studimi ka këto objektiva (citojmë RVB):

Objektiva të programit:

- a) Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë, e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, veprimtarisë kërkimore-shkencore si dhe shërbimeve në fushat e aktivitetit fizik për shëndet, fitnesit, rekreacionit, turizmit sportiv e të aventurës etj, dhe të formojë specialistë të lartë e të përgatisë kuadro e shkencëtarë të rinj në këtë drejtim;
- b) Të mundësojë formimin e vazhduar akademik e profesional jo vetëm të trupës pedagogjike, por dhe rritjen e vazhdueshme në planin teorik e praktik të studentit gjatë gjithë kohës së studimeve duke patur në fokus rritjen e vlefshmërisë së diplomave që nxjerrim për tregun e punës;
- c) Të ndihmojë në krijimin e specialistëve të aftë e me kompetenca profesionale, të gatshëm për një treg pune i cili ka nevojë imediate për specialistë të fitnesit, rehabilitimit fizik, animacionit social e turistik dhe turizmit sportiv e të aventurës ;
- d) Të kontribuojë në rritjen e standardeve akademike e të kërkimit shkencor dhe të jetë një ambient kulture e qytetarie në shërbim të formimit jo vetëm të specialistëve të aftë, por dhe të një rinie të shëndetshme në funksion të zhvillimit perspektiv e shpresëplotë të shoqërisë shqiptare duke u siguruar atyre një diploma kompetitive dhe shume të kërkuar edhe në tregun europian të punës
- e) Të organizojë workshop-e, seminare, kumtesa, informacione shkencore në fushat e përcaktuara më sipër si dhe të jetë pjesë aktive në studime madhore jo vetëm lokale, por edhe kombëtare në fushat e aktivitetit fizik për shëndet dhe të turizmit sportive dhe impaktit të tij në ekonominë shqiptare.

Objektiva specifike të MP në MST:

- T'i pajisë studentët me njohuri bazë të Biznesit në përgjithësi dhe Menaxhimit të Sportit në veçanti.
- T'i pajisë të diplomuarit për Menaxhim në Sport dhe Turizëm me aftësitë dhe cilësitë e kërkuar menaxheriale që të jenë të përgatitur të përballen me sfida dhe të shfrytëzojnë shkallën e gjere të mundësive që ofron një nga industritë më dinamike;
- T'i ndihmojë studentët të vërejnë në praktikë aplikimin e qasjeve analitike dhe vlerësuese të hartuara për të nxjerrur zgjidhjen krijuese të problemeve në industrinë e sportit

- Të sigurojë përvojë praktike punë në industrinë e sportit. Studentët pasurojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara më herët që të zhvillojnë aftësi të reja menaxhimi dhe sjelljeje.

Programi MP MST synon t'i pajisë studentët me njohuri të thelluara në çështje që i ndihmojnë:

- Të shfaqin aftësi për të komunikuar në mënyrë të efektshme në situata biznesi me gojë, shkrim ose përmes përdorimit të medias elektronike.
- Të shfaqin aftësi për të ndërtuar një skuadër dhe të punojnë me efikasitet brenda saj
- Të shfaqin njohje dhe aftësi për të analizuar tendenca mjedisore (ekonomike, shoqërore, politike, ligjore, etike) dhe impaktin e tyre tek individë dhe biznese.
- Të përshkruajnë aplikimin e instrumenteve dhe metodave cilësore e sasiore, qofshin këto manuale ose kompjuterike, në identifikimin dhe zgjidhjen e problemeve dhe marrjen e vendimeve në situata biznesi.
- Të analizojnë dhe aplikojnë koncepte, teknika, strategji dhe teori nga disiplina të lidhura me botën e biznesit.
- Të përshkruajnë sistemin e shpërndarjes së sportit dhe turizmit dhe shpjegojnë mekanizmat e vendim marrjes në shkallë globale e lokale
- Të shfaqin aftësi për të hartuar plane për një organizatë sportive apo turistike.
- Të cilësojnë rolet dhe praktikën e ndryshme drejtuese që mund të gjejnë zbatim në mjedisin
- Të shfaqin aftësi të planifikimit dhe organizimit të ngjarjeve sportive dhe turistike.
- Të shfaqin vlerësim për nënkuptimet e rëndësishme etike dhe ligjore të vendimeve
- menaxheriale në sport dhe turizëm.

Mundësi profesionale dhe punësimi

Mbajtësi i kësaj diplome ka të drejtën të punësohet në organizata sportive (publike & private) në rang kombëtar dhe ndërkombëtar

- Shoqata dhe klube sportive
- Agjenci sportive
- Këshillime rreth sportit dhe turizmit
- Kompani turistike kryesisht në resorte, programe sportive dhe guida turistike.

Objektivat e programit të studimit sikurse janë paraqitur në RVB dhe u diskutuan me drejtuesit e UST janë të plota, të qarta dhe në përputhje me emërtimin e tij. Programi ka gjithashtu rëndësinë se është i pari i këtij lloji, në një drejtim të vecantë, novativ për vendin dhe si i tillë plotëson një mangësi dhe nevojë që tregu tashmë e kërkon. Mendojmë që tregu i punës në këtë profil, ka nevojë për specialistë dhe individë, të çertifikuar për menaxhim në sport dhe në turizëm, por jo rrallë, këtë boshllëk e kanë zënë individë pa trajnimin përkatës.

Profili kulturor dhe profesional, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë këtë program dhe objektivat specifike janë të qarta, të fokusuara dhe të përshtatshme për këtë program të karakterit profesional.

Strategjia afatmesme dhe afatgjate kërkon konsolidimin e rritjen e këtij programi studimi në shërbim të plotësisht të standardeve europiane në fushën e menaxhimit dhe shërbimeve në sport dhe turizëm. Kjo do krijojë në të ardhmen një kulturë shërbimi të një standardi të lartë, profesional, të matshëm dhe konkurrenës në rajon.

GVB e ka marrë në vëmendje këtë aspekt.

Vlerësimi sipas Standardeve




Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.</p>	<p>Në tërësinë e tij, programi i studimit është hartuar mbështetur në modele dhe përvoja të shkollave europiane. Është në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe hap pas hapi do fusë në treg, kulturën e menaxhimit profesional dhe legal, të munguar deri me sot.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Pohojmë që ky program studimi është në përshtatje me strategjinë e institucionit UST</p>
Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.	
<p>Kriteri 1 Përmbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Nga vizita që zhvilluam në UST, referuar dokumenteve të licencimit dhe nga studimi i materialit të GVB, pamë që referencat ligjore dhe nën ligjore, janë korrekte dhe nuk ka shmangje nga ligji.</p>
Standardi I.11 - Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënit.</p>	<p>GVJ konstatoi se UST ka një fill strategjik që udhëheq punën e këtij institucioni, i cili po punon të hapë fakultetin e tij të tretë.</p> <p>Paqëndrueshmëria që vihet re në ndonjë aspekt, mendojmë se duhet të korigjohet me qëllim konsolidimin e arritjeve.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> Objektivat e programit të studimit janë të plota, të qarta dhe në përputhje me emërtimin e tij. Programi ka gjithashtu rëndësinë se është i pari i këtij lloji, në një drejtim të vecantë, novativ për vendin dhe si i tillë plotëson një mangësi dhe nevojë që tregu tashmë e kërkon. Profili kulturor dhe profesional, njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë këtë program dhe objektivat specifike janë të qarta, të fokusuara dhe të përshtatshme për këtë program të karakterit profesional. Ky program studimi është i justifikuar, i kërkuar nga një treg në rritje, i mbështetur në ligjet e legjislacionit shqiptar dhe europian. UST me këtë program studimi, hedh një hap të rëndësishëm dhe në drejtimin e duhur, në formalizimin e tregut menaxherial, në sport dhe turizëm <p>Ne mendojmë se standardet në këtë program studimi, përputhen plotësisht me kriteret metodike të hartimit të një programi studimi, mbështetet në ligj, formalizon tregun e</p>	

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për çdo standard në mënyrë të përmbledhur (mbështetur në kriteret majtas). Në fund të çdo rubrike, grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardeve në tërësi.

2. Struktura akademike e Fakultetit (Departamentit përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Struktura e Fakultetit të Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit përbëhet nga 3 Departamente, si më poshtë:

- Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit (DOM)
- Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit (DVFRT)
- Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit (DLSH)

Departamenti përgjegjës për programin e studimit është Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit (DOM)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Struktura akademike e Universitetit, Fakultetit/departamentet (organigrama)**

Organigrama e plotë e UST jepet në Aneks.

- Personeli akademik për çdo njësi bazë: PAE, PAK, PA, titujt/gradat, (Tabelat në aneks)**

Gjatë vizitës dy ditore në UST, në dt 31-5-2018 dhe 01-6-2018, vëzhguam nga afër se midis RVB dhe realitetit që gjetëm atje, nuk ka dallime dhe se struktura akademike dhe cilësia e personelit akademik është e garantuar.

Përbërja e departamenteve me personel akademik është si më poshtë (Tabelat në Aneks)

- Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit ka në përbërjen e tij:
 - 9 PAE nga të cilët, 1 Prof. Dr.; 2 Prof. As.; 2 Dr.; 1 Doc.; 3 Msc.
 - 3 PAK nga të cilët, 3 Prof. As.
 - 1 PA që ka Diplomë e Integruar e Nivelit të Dytë
- Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreative dhe Turizmit, ka në përbërjen e tij:
 - 11 PAE, nga të cilët, 1 Prof. As.; 1 Doc./Dr.; 4 Dr.; 4 Msc.
 - 5 PAK nga të cilët, 2 Prof. As.; 3 Msc.
 - 2 PA, nga të cilët, 1 Diplomë të Integruar të Nivelit të Parë, 1 Diplomë e Integruar të Nivelit të Dytë
- Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit ka në përbërjen e tij:
 - 10 PAK nga të cilët, 2 Prof. As.; 2 Dr.; 6 Msc.

- 3 PAE nga të cilët, 1 Dr.; 2 Msc.
- 2 PA nga të cilët, 1 Diplomë të Integruar të Nivelit të Parë; 1 Diplomë të Integruar të Nivelit të Dytë

DOM ka 12 pedagogë gjithsej nga të cilët mbi 70% me tituj dhe grada shkencore

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënyrë që të përmbushë misionin e tij;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;</p> <p>Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tilla, nga të cilat dy departamente;</p> <p>Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Në të vërtetë programi i studimit është mirë menduar dhe konceptuar në harmoni edhe me vetë objektivat e UST dhe FVFR.</p> <p>Programi ka dimension social dhe përçon rolin e sportit në një linjë me frymën dhe kulturën europiane.</p>
Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Në vizitën që bëmë ne zyrën e Burimeve Njerëzore të UST, konstatoam se kriteret e rekrutimit ndiqen dhe zbatohen me seriozitet dhe përgjegjshmëri dhe se dosjet dhe praktika përzgjedhëse, administrohen dhe shërbejnë me transparencë.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit është hartuar dhe konceptuar në përshtatje me legjislacionin në fuqi dhe mbështetur në përvojën më të mirë europiane për këtë qëllim. 2. Personeli akademik, efektiv, me kontratë apo mbështetës, që jetëson programin e studimit, përmbush në normë dhe në cilësi realizimin e programit mësimor. Janë të gjitha garancitë që ky program studim të prekë suksesin dhe të rritet e pasurohet në vite. 3. Personeli akademik i angazhuar është me tituj e grada si edhe me eksperience në mësimdhënie 	
Bazuar sa më lart, mendojme se standardet plotësohen tërësisht.	

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik që në nisje të programit të studimit, është plotësuar me personel akademik mjaftueshëm profesional. Raporti midis personelit efektiv dhe atij me kontratë është dukshëm në favor të PAE. Janë zbatuar në tërësi kriteret e mbulimit të lëndëve nga personeli pedagogjik si dhe shpërndarja e ngarkesës mësimore sipas profilizimit dhe kualifikimit të çdo pedagogu, qoftë PAE/PAK. Konstatuam se bëhen përpjekje serioze për të zgjeruar rrjetin e operatorëve turistikë, sportivë. Pamë nga afër një investim serioz të Klinikës Gjermane, në pasurimin e bazës laboratorike.

Pohojmë se programi i studimit është i mbuluar mjaftueshëm me personel akademik të kualifikuar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat (Tabelat ne aneks)

GVJ vëzhgoi nga afër dokumentacionin zyrtar dhe gjeti se raporti midis PAE/PAK, për vitin akademik 2017-2018, është në favor të PAE, në raportin 11/3, përfshirë edhe një PA. (Tab 4.5.)

Në përqindje ky raport rezulton 78.5% e programit të studimit mbështetet nga personeli akademik efektiv dhe 21.5% nga stafi akademik me kontratë.

Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinator/ët e programit të studimit (Tabela ne aneks)

GVJ u informua drejt për drejt nga anëtarët e këshillit shkencor të DOM dhe mesuam që puna e tyre ishte e ndertuar mbi një program real dhe i mbështetur.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Tabelat ne aneks).

Në këtë program studimi zhvillojnë mësimdhënie 11 pedagogë si personel akademik efektiv, me kualifikim:

- 3 Prof Dr.
- 5 Prof.As
- 3 Dr

Në këtë program studimi zhvillojnë mësimdhënie edhe 3 pedagogë si personel akademik me kontratë, me kualifikim:

- 3 Prof.As


Pohojmë se titujt akademikë Prof. dhe Prof.As, zenë përqindjen me të lartë të DOM, tetë gjithsej, kundrejtë 3 Dr.

Të dhënat sipas seksit. Të dhëna sipas moshës së personelit (Tabelat në aneks)

Pohojmë që Raporti sipas seksit është dukshëm në favor të seksit mashkull, në raportin 9/2, për PAE dhe 2/1 për PAK. Ndërsa klasifikimi sipas moshës, është i ekuilibruar nga një grup moshë në tjetrën.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat (Plotëso Tabelat ne aneks)

Anëtarët e personelit akademik, në fillim të çdo viti akademik, nënshkruajnë kontratën e punës me titullarin e njësisë Kryesore. Në kontratë përcaktohen detyrimet dhe të drejtat e palëve.



Gjatë vizitës që bëmë në zyrën e burimeve njerëzore, ne u njohëm konkretisht me modele të kontratave të punës të plotësuara dhe me metodologjinë që ndjek departamenti për këtë qëllim.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë (Tabelat ne aneks)

Ne kontaktuam drejt për drejtë me personelin ndihmës mësimor, në vëndet e tyre të punës, në laboratorë dhe zyra shërbimi. Pamë nivel të kënaqshëm profesional në komunikim me ta, tek na tregonin për punën apo laboratorin që drejtonin me kompetencë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Sipas programi të ndërtuar, ne vizituam dhe pamë nga afër punën në institucion. Ne pamë me kënaqësi dhe konkretisht se të dhënat e GVB me atë çfarë ne vumë re, ishin në tërësi të përputhura. Kjo na bindi se puna për përmbushjen e programit të studimit është e mbështetur dhe e garantuar institucionalisht.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe për arritjen e tyre;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.</p>	<p>Pohojmë se personeli akademik ndihmës mësimor është i përgjegjshëm dhe i angazhuar. Pamë nivel të kënaqshëm profesional në komunikim me ta, tek na tregonin për punën apo laboratorin që drejtonin me kompetencë.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Konstatuam se një numër i lartë pedagogësh, është përfshirë në hartimin e kurrikulës dhe suksesin e programit të studimit.</p> <p>Vlerësimi i personelit bëhet në drejtim të: mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit në projekte shkencore, veprimtari në mbështetje të institucionit etj.</p>
Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat për rekrutim të personelit akademik janë të parashikuara në Statutin dhe rregulloren e UST (në nenet 29 dhe 30). Kriteret propozohen në varësi të vendit vakant nga strukturat eprore përkatëse.</p> <p>Gjatë vizitës në Zyrën e burimeve njerëzore u faktua se UST ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutim të personelit, mbështetur në aktet e mësipërme.</p> <p>Në përqindje, rezulton se 78.5% e programit të studimit mbështetet nga personeli akademik efektiv dhe 21.5% nga stafi akademik me kontratë.</p>

	<p>Vlerësimi i personelit bëhet në drejtim të: mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe kontributit në projekte shkencore, veprimtari në mbështetje të institucionit etj.</p> <p>Drejtoria Juridike, e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit si pjesë e strukturës, ka një bazë të dhënash për personelin dhe vendet vakante të punës, shpall dhe ndjek shpalljen e vendeve të lira, përpunimin e të dhënave, etj.</p>
<p>Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.</p>	
<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asociuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p> <p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Profesional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p> <p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.</p>	<p>Fakti që nga 11 PAE, tetë pedagogë i perkasin kategorise Prof. Dr. dhe Prof. As. dhe tre të tjerë mbajnë gradën Dr, dëshmon për nivel të kënaqshëm.</p> <p>Njëherazi, pergj. i departamentit dhe personeli plotësojnë kriteret që sigurojnë mbarëvajtjen e institucionit dhe suksesin e programit të studimit.</p> <p>Praktika mësimore udhëhiqet nga personeli efektiv.</p> <p>Përvoja dhe formimi akademik i pedagogëve të angazhuar është në përputhje me lëndën/modulin që ata mbulojnë. Një pjesë e personelit, edhe pse me formim në fushën e sportit apo të lidhur me sportin, ka përvojë konkrete dhe të suksesshme në drejtimin e institucioneve sportive apo strukturave administrative e menaxhuese sportive. Kjo lidhet dhe me vetë historikun e institucionit, si i pari në fushën e sportit në vend.</p> <p>Numri i madh i personelit akademik me titujt, Prof dhe Prof.As. paraqet një standard të lartë kualifikimi. Profesionalizmi dhe kompetenca, garantojnë një nivel të lartë të cilësisë së diplomimit!</p> <p>Plotësimi i këtij stafi, me figura drejtuese të institucioneve sportive si dhe tutorazhin nga institucionet ku do kryhet praktika, e plotëson më së miri nga pikpamja cilësore mbulimin e këtij programi.</p>
<p>Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave” apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.</p>	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin për marrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p> <p>Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5</p>	<p>Studenti në fund të programit mund të bëjë provim/ose mbrojtë temë diplome.</p> <p>Duke qenë se është master profesional, përfshirja në temë diplome nuk është e detyruar.</p>

<p>(pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.</p>	
<p>Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.</p>	
<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Deri tani nuk ka mbrojtje të temave të diplomave.</p> <p>Propozojmë që vetë institucioni, të hartojë një listë më fusha prioritare dhe të informojë studentët të zgjedhin fushat ku dëshirojnë të thellohen në studimet e tyre</p>
<p>Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>GVJ pa nga afër laboratorë modernë, me pajisje bashkëkohore, te cilat ishin përfituar nga pjesëmarrja në disa projekte të rëndësishme europiane, si Projekti SPEED etj, të cilët përfshijnë edhe trajnimin e stafëve ndihmës dhe laborantëve</p>
<p>Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>Personeli akademik, në përmbushjen e programit mësimor, është në përshtatje me aktet ligjore dhe nën ligjore dhe normimit që ka bërë vetë departamenti përkatës.</p> <p>Ngarkesa e Personelit akademik i punësuar me kohë të plotë në këtë program studimi, zbaton aktet ligjore për ngarkesën, sipas titujve/ gradave.</p>
<p>Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Nga zyra e personelit të UST, u njohëm konkretisht dhe me dosje konkrete, te punës që bën institucioni, për krijimin, ruajtjen dhe administrimin e fondit të të dhënave per PAE, PAK, PA.</p>
<p><u>Konkluzionet e vlerësimit:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Behet një punë serioze për rekrutimin e burimeve njerëzore të kualifikuar dhe kjo gjë është e pasqyruar më së miri në praktikën dokumentare të institucionit dhe na u vu në dispozicion çdo gjë që ne kërkua për të përmbushur misionin tonë. Përvoja dhe formimi akademik i pedagogëve të angazhuar është në përputhje me lëndën/modulin që ata mbulojnë. Një pjesë e personelit, edhe pse me formim në fushën e sportit apo të lidhur me sportin, ka përvojë konkrete dhe të suksesshme në drejtimin e 	

institucioneve sportive apo strukturave administrative e menaxhuese sportive. Kjo lidhet dhe me vetë historikun e institucionit, si i pari në fushën e sportit në vend.

3. Numri i madh i stafit me titujt, Prof dhe Prof.As. paraqet një standard të lartë kualifikimi. Profesionalizmi dhe kompetenca, garantojnë një nivel të lartë të cilësisë së diplomimit.
4. Plotësimi i këtij stafi, me figura drejtuese të institucioneve sportive si dhe tutorazhin nga institucionet ku do kryhet praktika, e plotëson më së miri nga pikpamja cilësore mbulimin e këtij programi.
5. Meqenëse programi i studimit vjen si risi në këtë institucion, duhet ende një kohë për të thelluar njohuritë dhe kompetencat në sport dhe turizëm, si për stafin akademik, ashtu edhe për grupet e interesit. Por duhet theksuar se fillimi është optimist dhe garanci për me tej. Rekomandojmë të ruhet dhe pasurohet kjo frymë në të ardhmen, duke ndjekur me përgjegjshmëri, sfidat e rritjes.

Mendojmë se në një vëzhgim serioz dhe të thellë të gjëndjes që bëri GVJ, standardet plotësohen

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

UST nga ana infrastrukturore dhe laboratorike vitet e fundit është plotësuar dukshëm, falë investimeve nga buxheti i shtetit dhe përfitimet nga përfshirja në projekte të rëndësishme si Projekti JEP, viti 2006-2009 dhe Projekti SPEED 2012-2016. Keto investime e kanë ofruar institucionin me kërkesat dhe standartet e shkollës europiane.

Nga RVB dhe vizita në institucion rezulton se (citojmë RVB):

Mësimdhënia dhe aktivitetet e tjera të MP MST zhvillohen në godinën qendrore në dispozicion të UST. UST ka zyra për stafin akademik, bibliotekë, laborator informatike, laborator biomekanike, Laborator Biokimie dhe laborator të psikologjisë sportive, sekretari mësimore dhe staf ndihmës administrativ, salla leksionesh dhe seminaresh, zyrat e departamenteve si edhe mjediset sportive, palestra e lojërave, palestra e gjimnastikës, laborator i fitnesit, terrenet për kalçeto , për tenis, fusha e futbollit me pistën e atletikës etj. Për MP MST shfrytëzohet Salla Nr. 6 në katin e tretë të godinës qendrore, si për leksione si edhe për zhvillimin e seminareve.

Biblioteka e Universitetit

Ndërtesa e Bibliotekës është rikonstruktuar në vitin 2009 dhe ka një sipërfaqe prej 250 m². Në bibliotekë ka 48 vende leximi si dhe biblioteka është e pajisur me 12 kompjutera në ndihmë të lexuesve.

Në bibliotekë ndodhen rreth 3500 kopje (1740 janë tituj në gjuhë të huaj dhe 440 tituj në gjuhën shqipe). Rektorati i Universitetit të Sporteve i akordon bibliotekës fondet buxhetore.

Biblioteka e Universitetit të Sporteve është mbështetur edhe nga donatorë si: Ambasada Gjermane, Ambasada Franceze, Projekti Tempus "Sport Science Curricula in Albania and the Bologna Process Tempus JEP Sept 2006 – Aug 2008".

Materialet e koleksioneve mund të kërkohen nëpërmjet katalogut online. Në bibliotekë është instaluar programi KOHA, në bashkëpunim me Universitetin e Arteve me një projekt të



përbashkët ndër-institucional me anë të cilit wshtw krijuar Katalogu online nëpërmjet aplikimit të sistemeve open source (me asnjë kosto për përdoruesit).

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit (shih Tabelën në Aneks)

Mjedise për studentët rezultojnë

- 1 Sallë për leksione
- 1 Klasë për seminare
- 2 Sallë për aktivitete promovuese/praktikë lëndore profesionale
- 5 Laboratorë
- 5 Ambiente sportive, Palestra dhe fusha sportive
- 1 Sallë interneti
- 1 Zyrë informacioni për studentët
- 1 mjedis për qeverinë studentore
- 1 Mjedis shlodhës si kafeteri, fast-food,
- 7 nyje hidrosanitare
- Oborr i gjelbëruar

Mjediset për stafin:

- 3 Zyra për Dekanin/ kancelarin
- 1 Zyrë për sekretarinë mësimore
- 3 Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore
- 12 Zyra për personelin akademik
- 2 zyra për administratën
- 7 nyje hidrosanitare

Ndërtesa e re, e përfunduar së fundmi, ka siguruar kushte optimale pune për tre fakultetet (çdo fakultet shtrihet në një kat) dhe njëherazi siguron salla leksionesh moderne, mjedise per PAE, PAK, PA, tualete etj.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përhershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;</p> <p>Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;</p> <p>Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm për arritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizimin e programeve të studimeve që ofron;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të</p>	<p>UST ka një godinë të përhershme, se fundmi te plotësuar më së miri</p> <p>Këto mjedise janë në dispozicion te UST si prone e përhershme e tij</p> <p>Programi i studimit është i mbuluar nga ana infrastrukture në masën mjaftueshëm</p> <p>Për të përmbushur nevojat e praktikës mësimore, institucioni, përveç mjediseve te tij, shfrytëzon, mbështetur në marrëveshje edhe mjedise te tjera ku studentët drejtohen për te</p>

<p>parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.</p>	<p>kryer praktikën mësimore.</p> <p>UST është përfshirë në disa projekte të rëndësishme europiane, që kanë rritur ndjeshëm kapacitetin infrastrukturor, teknologjik dhe profesional.</p>
<p>Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Institucion vë në dispozicion bibliotekën e tij pa kushtëzim për studentë.</p> <p>Biblioteka ka një fasho librash dhe revistash shkencore bashkohore që ndihmojnë kërkimin shkencor.</p> <p>Po bëhen përpjekje serioze për të siguruar librari elektronike.</p> <p>Ka një plan të mirë detajuar për shtimin e zërave në bibliotekë, por mësuam se tenderi i blerjes së librave, kishte dështuar dhe kjo kishte sjellë vonesë në sigurimin e fondit të librit.</p> <p>Studentët na relatuan se biblioteka dhe stafi i saj, janë në dispozicion në çdo kohë.</p>
<p>Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshëm dhe mjedise të përshtatshme mësimore.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.</p>	<p>Infrastruktura e tashme, është e mjaftueshme në tërë treguesit bazë dhe mundëson përrmbushjen e programit të studimit.</p> <p>Pajisjet janë në përputhje dhe në përshtatje me synimet e programit të studimit.</p> <p>Laboratorët janë mjaftueshëm të paisur dhe niveli i laborantëve profesionistë, gjë që garanton mbarëvajtjen e programit dhe aftësimin e studentëve në to.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p>	
<ol style="list-style-type: none"> 1. UST tashmë është një institucion i mirë paisur me infrastrukturë, me baze laboratorike, me aksesore (plotësues), që garantojnë një punë normale në përrmbushjen e programit të studimit, që mbështesin studentin në punën e tij dhe sigurojnë cilësi. 2. UST është përfshirë në disa projekte të rëndësishme europiane, që kanë rritur ndjeshëm kapacitetin infrastrukturor, teknologjik dhe profesional. 3. Literatura kërkohet të shtohet më tej, pasi vitet e ardhshme parashikohet edhe rritja e numrit të studentëve. Ndaj më shumë fonde financiar për pasurimin gradual të bibliotekës edhe si qasje në fondin elektronik 	
<p>Si përfundim, pavarësisht nga nevoja për shtim fondesh për bibliotekën, mendojmë se standardet në infrastrukturë plotësohen.</p>	

Për të ardhmen rekomandojmë:

1. Të rritet fondi për sigurimin e literaturës profesionale;
2. Të stimulohen pedagogët të shkruajnë dhe botojnë në këtë fushë të etur për botime.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkrimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Nga vizita në universitet si edhe nga dokumentacioni në dispozicion, RVB i ka reflektuar me vërtetësi gjendjen e të ardhurave dhe financimet. Konkretisht :

Burimet e financimit janë:

- a. grandi i pakushtëzuar i financuar nga MASR,
- b. të ardhurat e Universitetit nga tarifat e shkollimit
- c. shërbimet me të tretë,
- d. të ardhurat nga pushteti vendor
- e. të ardhura nga aktivitetet tregëtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)
- f. Të ardhura nga pushteti vendore, grante apo kontrata nuk ka (nuk janë paraqitur të dhëna)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi:

Në mënyrë të detajuar, të dhënat e të ardhurave dhe financimeve faktike janë në Tabelën 8 ne aneks.

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik

Në dokumentacionin disponibël nuk ka kalkulime për koston e studimit për një student. Por në dokumentacion specifikohet se tarifat e ciklit të dytë të studimeve miratohen në Senat dhe në Bordin e Administrimit. Vec kësaj, specifikohet se në përcaktimin e tarifës së shkollimit janë mbajtur parasysh:

- a) shpenzimet për mbulimin e pagesave të personelit akademik,
- b) shpenzimet për funksionimin e këtij programi studimi,
- c) amortizimi për numër studentësh, për përdorimin e pajisjeve të ndryshme dhe godinave të UST.

Duke pasur në konsideratë edhe hapësirat dhe kufizimet që ofrojnë aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, megjithatë nuk është vënë në dispozicion kalkulimi konkret i dokumentuar.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	

<p>Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit të të ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p>	<p>Duke u bazuar në kërkesat ligjore, Raporti i auditimit pasqyron situatën e financimit të programeve të studimit në UST.</p> <p>Ky auditim kryhet vetëm nga MASR. UST nuk ka një strukturë auditimi të brendshëm. Kjo justifikohet nga institucioni me madhësinë e Institucionit. Prania e strukturës së auditit, qoftë edhe me një individ është mjaft e domosdoshme, ndaj e rekomandojmë të ngrihet vitin e ardhshëm akademik.</p> <p>Në lidhje me grandet e huaja, ato auditohen nga partnerët e huajt. Kështu, projektet europiane kanë patur auditim, kordinatori kryesor Universiteti “Foro Italico”, për financimin e Projektit për programin e studimit të ciklit të dytë të studimeve.</p> <p>Pjesë thelbësore e punës së auditit është edhe analiza dhe efica e përdorimit të të ardhurave, që pasqyrohet në raportin e auditit. Në raport janë evidentuar dhe analizuar përdorimi i të ardhurave nga tarifat e shkollimit.</p>
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

<p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme financiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fikse të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>Institucioni ka për detyrë dhe e zbaton paktikisht hartimin dhe miratimin e raportit financiar në këto drejtime:</p> <ul style="list-style-type: none"> - aktivitetin mësimor, - aktivitetin kërkimor shkencor - aktivitetin ekonomik administrativ <p>Ky raport përcillet çdo çdo vit në Senat dhe në Bordin e Administrimit për miratim pëfundimtar.</p> <p>Sikurse e theksuam edhe në pjesën përshkrimore, Bordi i administrimit miraton dhe tarifat e shkollimit të programeve të studimit sipas analizës së kostos për çdo program studimi.</p> <p>Raporti i auditimit tregon se institucioni ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e studimit.</p>
----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Konkluzionet e vlerësimit:

Nga analiza e dokumentacionit dhe vizita në institucion rezulton se:

1. Institucioni ka dokumentacionin e kërkuar për të evidentuar dhe verifikuar gjendjen financiare të instiucionit;
2. Institucioni zbaton paktikisht hartimin dhe miratimin e raportit për-aktivitetin mësimor, aktivitetin kërkimor shkencor dhe aktivitetin ekonomik administrativ;
3. Auditimi kryhet nga MASR; Raporti i auditimit tregon se institucioni ka kapacitete financiare të mjaftueshme për të garantuar qëndrueshmërinë dhe cilësinë e studimit.

Duhet që Institucioni të ketë mundësinë e vet të auditit pavarësisht nga arsyetimi i strukturave të pakta. Gjithashtu, dokumentacioni i kalkulimeve të detajuara të kostove duhet

të jetë më i plotë dhe më i mirëmbështetur.

Bazuar në arsyetimin e mësipërm gjykojmë se standardet plotësohen, por të plotësohet argumentimi e skema e llogartjes së kostove e tarifave të programit.

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Institucioni e ka ngritur NJSBC me tre anetarë (shih Tabelën me anëtarët e kësaj njësie, ne Aneks). Njësia është krijuar në Shkurt 2018 dhe menjëherë nisi nga puna. Kjo njësi është duke u organizuar për të kryer detyrat që i jep Ligji Nr.80/2015 “Për Arsimin e Lartë në RSH” dhe udhëzimet përkatëse nga MASR;

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

- Sa anketime kanë bërë me studentët
- Sa studentë janë anketuar
- Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë
- Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

NJSBC ka kryer një anketim me studentët. Rezultoi që 75% e studentëve u përfshinë në anketim dhe u shprehën.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

NJSBC është duke u strukturuar për të përmbushur detyrat që i ngarkon ligji

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

Nga taktimi me NJSBC, GVJ mësoi se janë të qartë lidhur me misionin e tyre dhe rrugët ligjore që duhet të vijojnë.


Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Nga shqyrtimi i pyetësorëve bërë nga NJSBC, ato u shprehën se studentët janë shfaqur falenderues për pedagogët, për mësimdhënien, për infrastrukturen etj. Këtë vlerësim e morëm edhe gjatë takimit me studentët.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Përmirësimi i cilësisë mbetet një sfidë dhe NJSBC është e përfshirë në kapërcimin me sukses të saj. Mendojmë se testimi i parë do të shërbejë për të gjetur indikatorë më të mirë të vlerësimit të cilësisë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion



GVJ u njoh me dokumentacionin e NJSBC dhe sugjeroi që njësi që t'i administrojë dhe ruajë të dhënat nga anketimi, që mund të vlejë për studime në të ardhmen.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të tërthorta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve në këto programe në vitet e mëparshme akademike apo në ciklet e ndryshme të studimeve; Sondazhe të vlerësimit të mësimdhënies, kurrikulës, të të mësuarit; Pyetje konceptuale; Intervista; <p><u>Të drejtpërdrejta:</u></p> <ol style="list-style-type: none"> Rezultatet e arritura nga studentët në teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara, etj); Dëgjime në auditor; Rezultatet e arritura nga studentët në provimet e vlerësuara me nota/pikë; Rezultatet e arritura nga studentët në testimet paraprake dhe përfundimtare, provimet për module, praktikat profesionale; Rezultatet e arritura nga studentët në vlerësimin e detyrave të kryera gjatë zhvillimit të programit të studimit (punë individuale apo në grup, detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, referatet, projektet, provimet, etj.); Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës; <p>Rezultatet e arritura dhe cilësia e rezultatit të kërkimit - tezës;</p>	<p>Instrumentat vlerësues të ecurisë së programit të studimit përdoren në institucion</p> <p>Mungojnë të dhënat për vetëvlerësim sistematik, sepse programi studimit është në vitin e parë të tij.</p> <p>Ka një faqe ueb për këtë qëllim.</p> <p>Mqs është viti i parë i programit të studimit, mundësia për të intervistuar studentë të karrierës, mungon.</p> <p>GVJ konstatoi nga biseda me grupin studentor se janë zhvilluar edhe metoda të tërthorta pune me ta, por edhe metoda të drejt per drejta apo të miksuara.</p> <p>Nga ekspertët e vlerësimit sugjerohet që:</p> <p>Të merret mendimi me shkrim i studentëve per punën e pedagogut dhe kjo të përbëjë një praktikë pune normale.</p>
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	
<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Programi studimit është në vitin e parë dhe vlerësimi i brendshëm është në fillësë për të nxjerrë përfundime tërësore</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë</p>	<p>Po grumbullohen të dhëna që do përbwjnë bazën e një analize vjetore, në përfundim të vitit të parë të programit të studimit, master profesional në menaxhim në sport dhe turizëm</p>

dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formale për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Institucioni ka plotësuar mjaftueshëm standartet e akreditimit të programit të studimit</p> <p>Institucioni ka përcaktuar instrumentat ligjorë dhe metodikë për sigurimin e cilësisë</p> <p>Përdor mekanizma formale për garantimin e cilësisë së programeve të studimit (si intervista me studentë, vlerësimi i punës së pedagogut, etj)</p> <p>Bëhen përpjekje serioze për ndërgjegjësimin e pedagogëve, studentëve lidhur me cilësinë e programeve të studimit, me rritjen e profesoratis dhe rritjen e nivelit të prurjeve nga bachelor në master.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	
<ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit që analizojmë, është në vitin e parë të zbatimit dhe disa aspekte të funksionimit të tij mbeten të shëndoshen me rritjen e përvojës. Megjithatë, përpjekja për sigurimin dhe garantimin e cilësisë të programit të studimit është e dukshme 2. Strategjia e institucionit, qartëson mënyrat dhe rrugët formale për rritjen dhe sigurimin e cilësisë, si brenda UST, ashtu edhe jashtë saj, në mjediset ku studentët zhvillojnë veprimtari dhe praktikën profesionale <p>Mendojme se standardet plotësohen kryesisht, duke marrë në vlerësim se është viti i parë i zbatimit të programit të studimit.</p> <p>Për të ardhmen rekomandojmë;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të sigurohen faktorët të monitorimit gradual dhe në vijimësi, të ecurisë së programit të studimit, të sfidave dhe sukseseve të tij. 2. Të shikohet mundësia e një analize tërësore pas një periudhe së paku 3 vjeçare në lidhje me ecurinë e programit të studimit, shkallës dhe cilësisë së punësimit, me synim, përmirësimin e aspekteve që meritojnë të pasurohen. 	

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Siç është shkruar dhe më lart Programi i studimit Master Profesional në “Menaxhimi në Sport dhe Turizëm”, ofron përgatitje profesionale në zbatimin e parimeve të biznesit në sport dhe industrinë e turizmit dhe është një program akademik i orientuar drejt tregut të punës.

Gjatë vizitës në UST, u njohëm konkretisht me përmbajtjen e programit të studimit dhe aspektet e rëndësishme që e shoqërojnë programin. Këtë aspekt e diskutuam edhe në bisedën që zhvilluam me studentët, se sa ata e ndjenin që programi i studimit përputhej me interesat e formimit të tyre profesional.

Programi shtrihet në 1 vit (2 semestra/60 ECTS). 1 ore mësimi 60 minuta, por në zbatim të VKM Nr.41 datë 24.01.2018 në semestrin e dytë ora mësimore ka zgjatur 50 minuta.

Shtrirja një vit akademik/60 ECTS, është e përshtatshme për këtë lloj programi studimi, për qëllimin dhe objektivat e formimit që paraqiten, më e pëlqyer për studentët dhe në të njëjtën kohë e mjaftueshme për realizimin e këtij programi dhe përmbushjen e tij për përgatitjen cilësore teorike dhe praktike.

Ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese (nga A-F) është si më posht (Shih Tabelën në Aneks):

- | | |
|-----------------------------------------------------------|------------|
| - Veprimtari në disiplina të formimit të përgjithshëm (A) | 13 kredite |
| - Veprimtari në disiplina të formimit karakterizues (B) | 30 kredite |
| - Vepr. në disiplina të Ngjashme dhe/ose integruese (C) | 5 kredite |
| - Veprimtari në disiplina me zgjedhje (D) | 3 kredite |
| - Veprimtari te tjera (praktikë në terren) (E) | 4 kredite |
| - Teza e Diplomës (F) | 5 kredite |

Mendojmë se kjo ndarje është harmonike, por në të ardhmen mund të rishihen kreditet në praktikën profesionale, për t'i rritur ato të paktën në 6 kredite.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Programi i studimit hapur me Urdhër Licensimi: UMAS Nr.395, datë 09.05.2015.

Qëllimi i programit të studimit është përgatitja e studentëve me zotësi dhe aftësi të plota për menaxhim në sport dhe turizëm. Përvehtësimi i artit të menaxhimit në auditor, outdoor dhe praktikë profesionale.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 31 javë mësimore (24 javë në auditor dhe 5 javë mësim praktik)
- Semestri i parë ka 16 javë mësimore (14 javë në auditor dhe 2 javë mësim outdoor)
- Semestri i dytë ka 15 javë mësimore (10 javë në auditor dhe 5 javë praktikë)
- 1 kredit (ETCS) është i barabartë me 25 orë pune të studentit
- 1 orë mësimore 60', në semestrin e dytë aplikohet ndryshimi 50'

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë (shih Tabelën në Aneks)

Plani mësimor është paraqitur i zgjeruar në Aneks. Aty jepen detaje për ndarjen e kreditove në leksione/seminare/praktikë/laboratore/punë për tezën e diplomës/punë të pavarur të studentit , etj

Lëndët dhe modulet, të ndara sipas veprimtarive formuese janë të strukturuar saktë dhe përputhen me emërtimin e programit, objektivat e përgjithshme dhe specifike të programit.

Vlerësojmë që theksi vihet cilësisht tek formimi i studentit master, me njohuri mbi ekonominë dhe biznesin. Kjo gjë plotëson një dimension të munguar në formimin profesional të studentit master, që vjen nga fusha sportive.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit.

Përcaktimi i orëve për 1 kredit, në lëndë të ndryshme është bërë brenda intervaleve, si më poshtë:

- | | | |
|------------------------------|-------------------------|--------------------------------------|
| ▪ Për leksionet | 5-7 orë në auditor dhe | 18-20 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Seminaret | 6-10 orë në auditor dhe | 15-19 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Për Praktikën Profesionale | 1 orë në auditor dhe | 24 orë punë e pavarur e studentit |
| ▪ Provimi përfundimtar | 0 orë në auditor dhe | 25 orë punë e pavarur e studentit |

Plani mësimor është i plotë, me të gjitha lëndët dhe modulet me ngarkesën e përgjithshme dhe të ndara sipas formave të mësimdhënies dhe orëve të ngarkesës mësimore.

Mendojmë që ka një raport të harmonizuar mirë, midis sasisë së orëve mësimore në auditor me orët jashtë auditorit. Ky raport shprehet në shifrat 675/825 orë dhe në total, përmbushin normën e 1500 orë vjetore. Orët në auditor, 675 (më e lartë se ngarkesa minimale e kërkuar, 600 orë) justifikon karakterin profesional që ka ky program studimi, ku pesha e orëve praktike/profesionale ka rëndësi të vecantë për arritjen e objektivave të formimit. Në këtë kuadër, rritja e lehtë e orëve të praktikave, do e përmirësonte programin.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën në Aneks)

Plani është i njëjtë me atë që është licencuar dhe nuk ka ndryshime.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës (Tabela në Aneks)

Nga Tabela dhe nga shqyrtimi i CV, rezultojnë këto përfundime:

- Personeli akademik është në përputhje me kualifikimin që kërkohet
- Personeli akademik ka përputhje të fushave akademike të kualifikimit, me fushat akademike të lëndëve

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Nga analiza e syllabuseve rezulton se ato përmbajnë elementët e mëposhtëm:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit
- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve

- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Nga vlerësimi, del qartë se Syllabuset e lëndëve, janë hartuar me pergjegjësi profesionale, mbështetur mbi një format të miratuar nga senati UST dhe plotësojnë tërësisht standartet më të mira, në formë dhe në përmbajtje.

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me personelin akademik dhe studentet, u njohëm konkretisht me përmbajtjen e dokumentacionit të programit të studimit. Në syllabuset përkatëse njohuritë dhe tematikat e paraqitura janë realisht të një stadi më të avancuar se ato të ofruara në ciklin e parë.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit është në përshtatje me kriteret për kreditet dhe sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti akademik me kohë të plotë, nga një student është 60 kredite.</p> <p>Programi Master Profesional MST ka kaluar procedurën së vlerësimit fillestar nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit, pas së cilës është hapur në bazë të Urdhërit Nr.395, datë 09.05.2017 të MAS.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë “Master i Shkencave”, “Master i arteve të bukura” apo “Master Profesional” i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare “Bachelor” me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë profesional;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe “Master Profesional” synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinar, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe kompetenca shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve “Master i Shkencave” ose “Master i arteve të bukura” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njohurish për studimet e ciklit të tretë</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional synon thellimin e njohurive të marrë në sistemin bachelor.</p> <p>Pranimet në master kanë ndjekur kriterin e notes mesatare mbi 6.5</p> <p>Një kriter shumë i rëndësishëm është thellimi i përpjekjeve për të orientuar studentët master drejt kërkimit dhe hulumtimit, si individualisht, ashtu edhe për studime më të gjëra dhe në grup.</p> <p>Fusha e menaxhimit në sport dhe në turizëm është e pa mbuluar me studime serioze, ndaj kjo mbetet një sfidë për të gjithë ata që ndjekin studimet master në këtë program studimi.</p>

<p>doktoratës, duke përfshirë aftësimin për kërkimin shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njohuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p> <p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionale, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</p>	
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përmbajtja dhe renditja e objektivave të programeve të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p> <p>Kriteri 2 Metodatat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njohurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Studentët shtojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara më herët, duke marrë aftësi të reja menaxhimi dhe sjelljeje përmes kurrikulës së ofruar.</p> <p>Vlerësimi periodik i rezultateve të punës së studentëve master është realizuar me seriozitet dhe i dukumentuar mirë.</p> <p>Institucioni ka kohë që është përfshirë në sistemin e menaxhimit të sekretarive të Universiteteve (nga RASH), dh menaxhimi i tyre është shumë i saktë.</p> <p>Për këtë morëm informacion nga takimi me sekretarinë mësimore</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavejeçare dhe praktikatat e mira të vendeve europiane;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkurruese për nga elementet që përmbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njohurive të fituara, diplomatat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluara.</p>	<p>Programi MP MST është hartuar duke mbajtur dhe mbështetur në përvojën e programeve evropiane në këtë fushë, si psh në metodologjinë e e Projektit SPEED.</p> <p>Programi zhvillon aftësi dhe kompetenca të specializuara për fushën e sportit dhe turizmit: të përgjithshme, të veçanta dhe të transferueshme, që mundësojnë menaxhim dhe transformim të strukturave organizative në vendin e punës, qëndrim të pavarur dhe performancë të efektshme të destinuar për tregun shqiptar dhe të huaj.</p> <p>Ne sugjerojmë që edhe stafet pedagogjike, të ndërtojnë teste vlerësimi për studentët e tyre, me qëllim që edhe studentët të mund të shprehen me vlerësim për pedagogët e tyre dhe punën që ata bëjnë.</p>
<p>Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Programi përputhet me profilin e UST dhe Departamentit të Organizimit dhe Menaxhimit, si dhe me strategjinë e zhvillimit të UST.</p> <p>CV e pedagogëve, të dhënat për kërkimin shkencor të pedagogëve janë tregues se pedagogët në këtë program, janë të angazhuar në veprimtarinë kërkimore shkencore dhe veprimtaria e tyre është në funksion të mësimdhënies dhe përputhet me synimet që ka përcaktuar ky program.</p> <p>Aftësimi profesional i studentëve master është një sfidë serioze në çdo etape.</p>

	Ne pamë që kjo çështje ishte marrë seriozisht dhe se zgjerimi i terrenit ku studentët do të zhvillojnë praktiken profesionale, si në aspektin e terrenit sportiv, ashtu edhe në aspektin e terrenit të biznesit, është një hap konkret dhe në kahun e duhur
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	<p>Nevoja e tregut të punës është arsyeja e parë dhe konkrete e hapjes së programit të studimit.</p> <p>MP MST synon të plotësojë kërkesat e bizneseve për specialitë me nivel kualifikimi universitar.</p> <p>Për këtë drejtuesit janë mobilizuar të zgjidhin edhe problemin ligjor të marrjes së <i>licencës së profesionit</i>, që të përputhet me diploma të tilla profesionale.</p>
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar a ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Në vizitën në fakultet mësuam që disa studentë që ndjekin programin e studimit, janë rekrutuar nga biznese në rolin e menaxherit, sepse edhe bizneset janë ndërgjegjësuar për nevojën e menaxherëve të trajnuar dhe të certifikuar</p> <p>Ne sugjerojmë që institucioni, të bëjë marketing me të zgjeruar, me qëllim që të kapërchet mos njohja dhe të rritet numri i aplikantëve që do të ndjekin vitin e ardhshëm akademik, këtë program studimi</p>
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interes kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	Aspekti kombëtar dhe njohja dhe promovimi i vlerave kombëtare, përbën synimin parësor të programit të studimit
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve "Master Profesional" realizohen me 60-90 kredite europiane ECTS. Kohëzgjatja normale e tyre është 1-1.5 (një deri në një vit e gjysmë) vite akademike.</p>	Programi i studimit është Master Profesional me 60 kredite dhe me zgjatje një vit akademik, mbështetur në Ligjin e Arsimit të Lartë.
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësisht i konsultueshem për studentët;</p> <p>Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në forma të ndryshme të shkruara dhe elektronike.</p>	<p>Programet janë të pasura në informacion, të qarta, të kuptueshme dhe të arritshme për studentë të motivuar.</p> <p>Syllabuset e lëndëve, janë hartuar mbështetur mbi një format të miratuar nga senati UST dhe plotësojnë tërësisht standardet në formë dhe në përmbajtje.</p>

	Gjithashtu, sikurse u deklarua nga Institucioni, në fillim të vitit akademik, studentëve u shpërndahen udhëzime më të detajuara për secilën lëndë/modul nga Departamenti dhe pedagogu përkatës.
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve "Master i Shkencave" janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Rregullorja e Studimeve për Programin përcakton kushtet dhe procedurën e diplomimit.</p> <p>Në planin mësimor të Programit janë parashikuar 5 kredite për Punim Diplome / Provim Formimi.</p> <p>Në planin mësimor të Programit janë parashikuar 4 kredite për Praktikë Profesionale.</p> <p>Ne sugjerojmë që të rritet nr i krediteve për t'i dhënë rëndësinë që i takon praktikës mësimore, nga 4 kredite që ka sot.</p> <p>Propozojmë që studenti në praktikë, të marrë dy vlerësime:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Vlerësim nga pedagogu shoqërues 2. Vlerësim nga institucioni pritës i praktikës
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Programi i studimit është strukturuar mire, në përshtatje me përvojën më të mirë të shkollës europiane dhe mbështetet në legjislacionin juridik dhe teknik të shtetit shqiptar. Kjo e bën programin e studimit bindës, bashkëkohor dhe premtues. 2. Plani mësimor është i plotë, me të gjitha lëndët dhe modulet me ngarkesën e përgjithshme dhe të ndara sipas formave të mësimdhënies dhe orëve të ngarkesës mësimore. Mendojmë që ka një raport të harmonizuar mirë, midis sasisë së orëve mësimore në auditor me orët jashtë auditorit. 3. Syllabuset e lëndëve, janë hartuar dhe miratuar nga senati UST dhe plotësojnë tërësisht standardet në formë dhe në përmbajtje. 4. Ky program studimi i shërben ruajtjes së vlerave kulturore dhe interesave kombëtare. Programi trajton, mbështet dhe kultivon vlerat më të mira nëpërmjet përmbajtjes mësimore, kërkimit dhe veprimtarive. 5. Cilësia e programit të studimit është e garantuar dhe stafi hartues, hulumton ecurinë e tij me qëllim ndërhyrjen sa herë që koha dhe zhvillimi do të imponojnë nevojën për ndryshim. <p>Gjykuar në tërësinë e faktorëve veprues, shprehemi se standardet plotësohen</p>	

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

GVJ pa nga afër që në institucion gjithëçka lidhej dhe i shërbente mësimdhënies, si një proces i parapërgatitur, sistematik dhe kontroll i atyre konditave në të cilat mësimi zhvillohet. Njëherazi

u prek nga afër fryma pozitive dhe optimizmi i studentëve lidhur me programin e studimit dhe punën serioze të stafit mësimdhënës.

Metodat mësimore dhe format e organizimit të orëve mësimore synojnë aspekte të ndryshme të të nxënies si: të nxënies përmes leksioneve, seminareve, praktikës, të menduarit kritik dhe krijues, etj

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet dhe orët përkatëse janë (Shih Planin mësimor:

• Leksione	233 orë mësimore në auditor
• Seminare	342 orë mësimore në auditor
• Praktikë profesionale	100 orë mësimore në auditor
• Temë diplome	125 orë punë pavarur e studentit

Programi i studimit, i kushton vëmendje të posaçme përsosjes së teknikave dhe instrumentave të kërkimit, si në terren, ashtu dhe me laboratorin modern të përpunimit informatik të të dhënave, gjë që është në përputhje me objektivat formuese të një programi 1 vjeçar, Master Profesional.

- Format e kontrollit të njohurive (Tabela në Aneks)**

Përdoren disa forma kontrolli të njohurive, si kontrolli me shkrim, hartimi i testeve dhe pyetoreve, kontrolli i drejtpërdrejt, kontrolli i vazhduar dhe sistematik, etj.

Në syllabuse është ëprcaktuar se format e kontrollit ndahen:

- Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive	10%
- Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)	10%
- Testimi gjatë vitit	35%
- provim përfundimtar	45%

Format e vlerësimit janë të qarta, të larmishme, frytdhënëse dhe alternative.

Edhe pse për programe studimi që janë të reja për sistemin tonë, literatura në gjuhën shqipe është problematike, hartuesit e syllbuseve janë kujdesur që në to të ketë literaturë të përshtatshme dhe të posaçme në shqip si dhe literaturë plotësuese.

Sigurimi i literaturës është gjithnjë një sfidë, por ky standard sigurohet dhe funksionon gjithnjë e më mirë edhe falë përgatitjes e përvojës së personelit akademik të angazhuar në këtë program.

- Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj**

Megjithëse ky është viti i parë i programit të studimit dhe nr i studenteve është relativisht i ulët, vetëm 16 studentë master, përfshirja e tyre në shqetësimet e përbashkëta është vlerësues.

Kjo u kuptua nga ana jonë në takimin e zgjatur që zhvilluam me studentet master. Ata u shfaqën të motivuar dhe deshmuar se njohin sfidat dhe janë të gatshëm të jenë aktivë në zgjidhjen e tyre. Studentet e vlerësuan punën e pedagogëve dhe përgatitjen e tyre si kompetentë të lëndës.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Programi i studimit që marrim në analizë, është në vitin e parë të zbatimit dhe disa tregues që lidhen me perspektivën, mungojnë për këtë shkak.

Nga vizita në institucion, nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës dhe takimi me studentë, GVJ mësoi se në tërësi puna me studentët e programit të studimit është serioze, e motivuar dhe e mbështetur në rregullore dhe dokumente. Gjatë bisedës grupi mori informacion të vlefshëm për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të tyre në institucion dhe jashtë tij.

Në këtë program studimi janë regjistruar 16 studentë.

Në RVB si dhe gjatë vizitës u evidentua se institucioni, në përputhje me aktet ligjore zbaton:

- Menaxhimin e të dhënave të studenteve (Regjistri bazë, Regjistri i notave, Sistemin e Menaxhimit të Studentëve ESSE3
- Informimin e studentëve (Manuali i studenteve, Faqja zyrtare e internetit, platforma ESSE3, rrjetet sociale si facebook, etj)
- Promovimi i programit për kandidatët (takime të stafit akademik me maturantë, panairë, fletëpalosje, media dhe ueb-i zyrtar)

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës, pamë që janë respektuar procedurat dhe udhëzimet e qeverisë për rekrutimin e studentëve mastër. Asnjë shqetësim apo ankesë nuk ka patur për këtë fazë të punës nga institucioni përkatës. Informimi i aplikantëve për kërkesat dhe dokumentacionin që kërkon futja në këtë program studimi, është zbatuar me përgjegjësi institucionale

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Të gjithë studentët e pranuar në këtë program studimi, i kanë përmbushur plotësisht kriteret bazë që ka vendosur institucioni. Mësuam se stafi kishte pretendime që mund të ishte arritur edhe më shumë në drejtim të cilësisë, që mbetet për t'u plotësuar në të ardhmen.


Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare (Tabela në Aneks)

Në vitin e parë 2017- 2018, në këtë program studimi u pranuan gjithsej 16 studentë, një numur duhet thënë, më pak se pritshmëria. Mesatarja e notës mesatare të tyre rezulton mbi 6.5.

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Theksojmë që është viti i parë i programit të studimit dhe këto të dhëna ende nuk janë vjelur!

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;</p> <p>Kriteri 2 Pranimi në programet e integruara të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;</p> <p>Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japin deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve “Master Profesional” niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve “Master i Shkencave” dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikën e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kriterëve të pranimit.</p>	<p>GVJ konstatoi në terren dhe në institucion se në tërësi, gjithë praktika dhe procedurat ligjore që lidhen me organizimin e programit të studimit dhe konkretisht, me rekrutimin e studentëve në këtë program, janë të mbështetura në akte ligjore dhe nën ligjore.</p> <p>Të gjithë studentët që ndjekin programin e studimeve “Master Profesional” “Master Profesional” në “Menaxhim në Sport e Turizëm” zotërojnë së paku diplomën universitare “Bachelor” dhe kanë grumbulluar 180 kredite në aktivitet fizik, shëndet dhe rekreacion, në shkenca sportive si dhe në ekonomi, menaxhim, turizëm ose në fusha akademike të ngjashme me to. Për t’iu përshtatur më mirë specifikave dhe natyrës ndërdisiplinore të këtij programi studimi, është vendosur kriter hyrës:</p> <p>a) Plotësimi me 5 kredite në Bazat e Ekonomisë (për studentët që zotërojnë të paktën Diplomë “Bachelor” në aktivitet fizik, shëndet dhe rekreacion apo në shkenca sportive)</p> <p>b) Plotësimi me 5 kredite në lëndë me karakter sportiv (për studentët që zotërojnë të paktën Diplomë “Bachelor” në Ekonomi, Menaxhim, Turizëm ose tjetër)</p> <p>Vlerësojmë që, kushtet specifike për regjistrimin e studentëve janë plotësisht të mjaftueshme, për rekrutimin e studentëve master profesional, nga disa burime alternative.</p> <p>Kjo rrit fleksibilitetin dhe mundësinë e mobilitetit të studentëve midis institucioneve të ndryshme publike në rang kombëtar.</p>
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikën e punësimit.	
<p>Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion;</p> <p>Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.</p>	<p>Koordinatori i programit monitoron dhe realizon takime informuese (në grup dhe individuale me studentët) duke patur në konsideratë specifikat e programit, sfidat për këtë program të ri si dhe duke vënë theksin në mundësitë që ofron tregu aktual i punës.</p> <p>Zyra e karrierës edhe pse ende pa përvojën e duhur, punon që të zhvillojë përgjegjësitë e saj institucionale, duke i ofruar studentëve mundësi orjentimi dhe këshillimi</p>
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të	

dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;</p> <p>Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.</p>	<p>GVJ konstatoi se për çdo student të përfshirë në programin e studimit, administrata e institucionit zotëronte dosje te veçantë dhe të mirë organizuar.</p>
-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.

<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe për vendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Është viti i parë i zbatimit dhe ende nuk ka bazë të dhënash.</p>
--------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	----------------------------------------------------------------------

Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.

<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Studentët në bazë të rregullores së programit marrin informacion për vlerësimet e punës së tyre.</p> <p>Gjithashtu kanë të drejtë të rishikojnë notën në të gjitha hallkat akademike</p> <p>(vlerësimi merret ne sistem dhe ankimimi gjithashtu)</p>
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>GVJ bisedoi me studentët dhe u prek realisht nga ana e tyre një vlerësim pozitiv për pedagogët dhe institucionin në tërësi.</p> <p>Koordinatori i programit dhe zyra për këshillimin e karrierës ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale, si dhe duke i ofruar asistencë për zgjedhjen e lëndës 'me zgjedhje', që i pershtatet me mire atyre.</p>
---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Konkluzionet e vlerësimit:

1. Institucioni ka dëshmuar korrektesë dhe gjithë puna që në nisje për këtë program studimi, është e mbështetur dhe e referuar në aktet ligjore dhe nën ligjore të legjislacionit përkatës të shtetit shqiptar
2. Për t'iu përshtatur më mirë specifikave dhe natyrës ndërdisiplinore të këtij programi studimi, është vendosur kriter hyrës -çka rrit kërkesat për cilësi në hyrje.

3. GVJ vlerëson që, kushtet specifike për regjistrimin e studentëve janë plotësisht të mjaftueshme, për rekrutimin e studentëve master profesional, nga disa burime alternative. Kjo rrit fleksibilitetin dhe mundësinë e mobilitetit të studentëve midis institucioneve të ndryshme publike në rang kombëtar.
4. Për çdo student të përfshirë në PS, administrata e institucionit zotëron dosje te veçantë dhe të mirë organizuar.

Për rrjdhojë, mendojme se standardet plotësohen

Rekomandojme për të ardhmen:

1. Të zgjerohet fusha e studentëve bachelor që duan te ndjekin këtë program studimi, duke pranuar nga fusha e historisë, e gjeografisë, gazetarisë, biznesit etj
2. Te reklamohen më shumë dhe më mirë, bonuset që ofron ky program studimi, duke përdorur për këtë qëllim një larmi formash të zhdërvjellta.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore

Një nga objektivat kryesore të IAL është edhe angazhimi në ëaktivitete të programuara kërkimore shkencore në funksion tëngritess cilësisë së mësimdhënies dhe të përgatitjes së studentëve. Në këtë kontekst, edhe UST ndjek një politikë mbeshtetëse në organizimin e seminareve, për prezantimin e projekteve dhe organizimin e konferencave ndërkombetare.

Nëse i referohemi të dhënave të dokumentuara por edhe të spjeguar gjatë vizitës në institucion, vërejmë se UST në këto dy vitet e fundit (2016 dhe 2017):

- ka organizuar 2 konferenca shkencore ndërkombëtare, nga një për cdo vit
- botime bianuale të revistës shkencore
- 7 sesione shkencore (nga ISKSH)
- organizon në mënyrë periodike Konferenën Shkencore ICSS
- ka një revistë shkencore Journal of Physical Activity and Sports për stafin dhe bashkëpunëtorë të vendit dh e të jashtëm

Por këto aktivitete, megjithë punën e mirë të bërë për nxitjen nga njësia kryesore dhe bazë, kërkojnë një planifikim më rigoroz të punës kërkimore. Por kjo kërkon dhe nxitje apo motivim në promocion dhe shpërblim. Nëse këtë e konsiderojmë mangësi, është e pranishme në gjithë sistemin e arsimit tonë të lartë pandaj institucionet duhet të bëjnë planifikime dhe përmirësime të organizimit dhe motivimit të punës kërkimore shkencore.

Universiteti, duhet pohuar se i bën të njohura rezultatet e kërkimit, mbeshtet financiarisht pjesëmarrjen e personelit akademik në simpoziume, kongrese e konferenca shkencore. Por kjo pavarësisht nga efektet pozitive nuk është e mjaftueshme, nëse i referohemi sugjerimit në paragrafin e mësipërm

Për një gjykim më të plotë mbi punën kërkimore, nga të dhënat duket se numri i projekteve të fituara dhe të zbatuara këto tre vite të fundit është respektivisht 8, 2 dhe 7. Numri i aktiviteteve shkencore është 4 ndërkohë që numri i pjesëmarrësve në këto aktivitete në total shkon në 72.

Ndërsa numri i studentëve të angazhuar është relativisht i ulët, rreth 20 vetë. Numri i projekteve në funksion të procesit mësimor është i pakët. Ndaj është dhe një nga pikat që kërkon më shumë vëmendje në të ardhmen. (për më shumë detaje referohuni tabelës 19 në anekse – Tabela e ofruar nga RVB është e verifikuar dhe të dhënat janë të sakta).

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>Sikurse duket edhe nga të dhënat e tabelës 19, vitet e fundit nr i botimeve nga personeli akademik është 192.</p> <p>Nga bisedat në institucion u pohua se ka procedura të planifikimit të punës vjetore shkencore, plotësimin e formularëve të planifikimit, raportimin në njësinë kryesore si dhe analizën vjetore në departament, dekanat dhe universitet. Personeli akademik nxitet, motivohet dhe përditëson njohuritë shkencore në disiplinën përkatëse.</p> <p>Është e vërtetë që ka angazhim të personelit akademik në punë shkencore (192 punime) çka jep ndihmesë të rëndësishme në cilësinë e procesit mësimor dhe të përgatitjen e studentëve. Por numri i projekteve në ndihmë të procesit mësimor në këtë program është i pakët, çka shpjegohet me faktin se është ende në vitin e parë të tij por kërkon më shumë vëmendje në të ardhmen në këtë drejtim.</p>
Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.	
